

**Padites:** **Shoqeria Loxhall SHPK**, me NIPT J71309005U, me adrese ne rrugen e Durrës, nr. 102, me perfaqesues Ilgjor z. Hamzeh Mohammad AbdelKarim Aburayyan, shtetas jordanëz, lindur me 25.07.1963, ne Halhul, Jordan, madhor, me zotesi te plate juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes jordanëze nr. L917857, perfaqesuar me prokure nga Av. Altin Ibro, me nr. 3781, me adrese (e cila do te perdoret per te gjitha njoftimet eventuale ne lidhje me kete ceshtje): Rruga Panorama, Pallati 16 katesh, Shkalla 3, kati 2, Ap. 2, Tirane (CC LAW OFFICE SHPK).

**E Paditur:** **Ministria e Financave**, Bulevardi Deshmoret e Kombit, nr. 3, Tirane.

**Agjencia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara (AAPSK)**, rruga Jordan Misja, Tirane.

**Objekti:** **Detyrimi i te paditurve te shperblejne paditesin per te gjitha demet e pasurore jashtekontraktore si pasoje sekuestrimit dhe keqadministrimit te llogarive bankare dhe pasurive te paluajtshme te paditesit, per periudhen kohore 2006-2013.**

**Baza ligjore:** Neni 1, Neni 11, 14, Neni 15/a dhe Neni 17 pika 1/f, e vijues te Ligjit Nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" (i ndryshuar), Neni 486 dhe 640 e vijues te Kodit Civil; Ligji nr. 9258 date 15.07.2004 "Per masat kunder financimit te terrorizimit" dhe akte ligjore te dala ne zbatim te tij; ligji nr. 8510 date 15.07.1999 "Per pergjegjesine jashtekontraktore te organeve te administrates shteterore" (i ndryshuar), ligji 157/2013 "Per masat kunder financimit te terrorizmit", VKM 2005 e vijim mbi kompetencat dhe funksionimin e Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara.

**PERPARA GJYKATES ADMINISTRATIVE TE SHKALLES SE PARE TIRANE**



E nderuar znj. Gjyqtare/I nderuar z. Gjyqtar!

Paditesi eshte nje shoqeri tregtare aktive ne Republiken e Shqiperise prej viteve 90-te. Kjo shoqeri ka qe nga fillimi ortak te vetem shtetasin nga Arabia Saudite Yassin Kadi.

**Per shkak te lidhjes me shtetasin Yassin Kadi, pasurite e paditesit, llogari bankare dhe pasuri te tjera te paluajtshme, i jane nenshtuar sekuestros per nje periudhe te gjate kohore, nga viti 2006-2013, duke i shkaktuar dem te rendesishem pasuror.**

Rrethanat qe lidhen me sekuestrimin e llogarive te paditesit lidhen me konsiderimin gablimisht te z. Kadi si financues/mbeshtetes te terrorizmit e perfshirjes se tij e personave te lidhur me te, ne sferen e masave te ndryshme shtrenguese ne Republiken e Shqiperise e me gjere.

Ne daten 10.12.2001, perfaqesuesit e Ambasades Amerikane ne Republiken e Shqiperise kane depozituar prane Drejtorise se Bashkerendimit te Luftes kunder Pastrimit te Parave" - Ministria e Financave, Urdhrin Ekzekutiv nr. 13224 date 23.09.2001 te Presidentit te SH.B.A-vë, bashkengjitur te cilit gjendej nje liste shtese per bllokimin e pasurive dhe ndalimin e transaksioneve te personave qe kryejne veprimtarj terroriste dhe mbeshtetin terrorizmin. I perfshire ne kete liste si i "dyshuar" ka qene edhe shtetasi arab Yassin Kadi i cili ishte i perfshire ne cilesine e ortakut ne disa shoqeri tregtare qe ushtronin aktivitet ne Shqiperi, ndermjet tyre edhe shoqeria "Loxhall" SHPK.

Ne daten 28.12.2001, pas Kallezimit te bere nga Ministria e Financave per shtetasin Yassin Kadi, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ka nisur procedimin penal nr. 2122 ne ngarkim te tij, me akuze per kryerjen e vepres penale te pastrimit te parave te pista". Ne vijim, nepermjet Urdhrit nr. 6737 date 14.11.2001 te Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane kerkohet nga te gjitha Institucionet ne Republiken e Shqiperise, qe te kontrollojne, te identifikojne, sekuestrojne, bllokojne dhe raportojne llogarite, Investimet, kompanite dhe pasurite ne emer te Yassin Kadi duke filluar nga data 17.10.2001.



Gjykata e Shkalles se Pare Tirane me vendim nr. 187 akti, date 18.01.2002, ka vendosur venien sekuestros prane bankave mbi te gjitha llogarite bankare personale apo llogari te shoqerise me emer apo te personave te lidhur me shtetasin arab Yasin Kadi, si dhe ne te njejten date edhe per pasurite e paluajtshme ne emer te tij dhe shoqerive e personave te lidhur me te.

Me vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 718 date 29.10.2004 "Per listen e personave te shpallur si financues te terrorizmit" Yassin Kadi u shpall si person qe hyn ne grupin e personave qe kane lidhje me financimin e organizatave terroriste.

Zyra e Prokurorit te Pergjithshem me daten 26.12.2004 vendosi pushimin e procedimit penal nr. 2122 date 28.12.2001 ne ngarkim te shtetasit Yassin Kadi si dhe te personave te lidhur me te, per vepren penale te pastrimit te parave te pista. Provat e sekuestruara ne zbatim te ligjit nr. 9258 date 15.07.2004 dhe te VKM nr. 718 date 29.10.2004, u vendos t'i kalojne per administrim Ministrise se Financave.

Me urdhrin nr. 2, date 03.12.2004 te Ministrit te Financave "Per sekuestrimin e aseteteve te shtetasit Arab Yassin Kadi" u jane sekuestruar edhe personave te lidhur me te (juridike dhe fizike) pasuri te ndryshme, nder to edhe llogari bankare e pasuri te paluajtshme ne emer te paditesit.

**Pasurite e paditesit jane administruar fillimisht nga Ministria e Financave e me vone (ne kohe te ndryshme prej vitit 2008 prej Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara.**

**Pasi shtetasi Yassin Kadi ka "pastruar" emrin permes investimit te gjykatave te ndryshme nderkombetare, Keshilli i Sigurimit i Organizates se Kombeve te Bashkuara e ka hequr emrin e tij nga lista e financuesve te terrorizmit. Kjo situatë është reflektuar edhe ne Republikën e Shqipërisë, kur Keshilli i Ministrave me VKM nr. 936 date 26.12.2012 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin nr. 718 date 29.10.2004, te Keshillit te Ministrave "Per listen e personave te shpalluar si financues te terrorizmit" te ndryshuar", vendos qe shtetasi Kadi, te cregjistrohet nga kjo liste.**

3  


Ne datën 01.02.2013 nepermjet Urdhrit nr. 7 të Ministrisë të Financave është vendosur të revokohet Urdhri i Ministrisë të Financave nr. 2, datë 03.12.2004 "Për sekuestrimin e asetëve të shtetasit arab Yassin Kadi, ndërsa në përmbajtje të tij urdherohen organet përkatëse të dorëzojnë pronarët të ligjshëm të gjitha pasuritë e sekuestruara nepermjet Urdhrit nr. 2 datë 03.12.2004, në rastin konkret edhe të pasurive të paditesit.

Po ashtu nepermjet Urdhrit nr. 7/1 datë 01.02.2013 është vendosur të ngrihet një grup i posaçëm për të realizuar dorëzimin e pasurive të paluajtshme të sekuestruara si dhe për të bërë dorëzimin e shumës së grumbulluar nga administrimi i pasurive nga ana e paleve të paditura. Ka nisur kështu një proces i cili fillon në shkurt të vitit 2013 e përfundon në tetor të vitit 2013, gjatë të cilit paditesit i janë kthyer fizikisht pasuritë e paluajtshme si dhe frutat civile të mbledhura për to e shumtë të sekuestruara në llogaritë bankare.


**Pavarësisht kësaj vendimmarrje, sekuestroja mbi pasuritë e paditesit ka prodhuar pasoja minimale deri më datën 24.10.2013, datë në të cilën paditesit i është kthyer shuma e fundit e sekuestruar që përfaqëson fruta civile të pasurive të sekuestruara, nga përfaqësuesit e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.**

**Sqarojme se sekuestrimi dhe administrimi i pasurive të paditesit është bërë në mënyrë jo transparente dhe në bindjen të kundërshtimit me ligjin në fuqi. Paditesit është informuar mbi këtë proces në mënyrë të cunget e kryesisht përmes procesverbaleve të mbajtura me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara datë 20.03.2013, 20.03.2013, 20.03.2013, 25.03.2013, 25.03.2013, 25.03.2013, 27.03.2013, 16.05.2013, 28.05.2013, 27.03.2013, 27.03.2013, 27.03.2013, 27.03.2013, 28.05.2013, 24.10.2013, 15.05.2013, 07.05.2013, 27.03.2013, 27.03.2013, 28.05.2013, 28.05.2013, 27.03.2013.**

**Pasuritë e sekuestruara paditesit tëpen në vijim:**

Me urdhrin nr. 2, datë 03.12.2004 të Ministrisë të Financave janë sekuestruar:

1. Llogari bankare n.r 100164, UBA në USD (0.22 USD).
2. Llogari bankare Nr 20051535301, ISP në USD (190 USD).

 4

Me urdhrin nr. 6, date 25.11.2005 jane sekuestruar:

1. Llogari bankare nr. 100164, UBA ne EURO (EUR 63 180).

Me urdhrin nr. 36, date 27.11.2006 jane sekuestruar pasurite e paluajtshme si me poshte:

1. Pasuria (apartament) me siperfaqe 114.4 m<sup>2</sup>, ne zonen kadastrale 8380, volumi 3, faqe 37, numer pasurie 283, date 12.1.1994 me adrese: Tirane, rruga "Vaso Pasha", pallati 2, shkalla 2,apartamenti 5 (i cili eshte i perbere nga tri dhoma, nje kuzhine, banje, korridor, ne katin e I-re mbi bodrumet), (indeks 111-283-12011994).
2. Pasuria (apartament) me siperfaqe 75.5 m<sup>2</sup>, ne zonen kadastrale 8380, volumi 13, faqe168, numer pasurie 7/135+7-86/2, date 10.5.2000, me adrese: Tirane, rruga "Rreshit Collaku",pallatet e Shalvares, shkalla 7, apartamenti 86, (i cili eshte i perbere nga tri dhoma dhe ambiente te tjera ndihmese), (indeks 155-19747-04071994).
3. Pasuria (apartament) me siperfaqe 71.3 m<sup>2</sup>, me adrese: Tirane, rruga "Bajram Curri",pallati 8, shkalla 1, apartamenti 3, (i cili eshte i perbere nga dy dhoma, nje kuzhine dhe ambiente te tjera ndihmese), (indeks 173-27518-14111994).
4. Pasuria (apartament) me siperfaqe 88 m<sup>2</sup>, volumi 3, faqe 37, numer pasurie 1/4+4-34, date 26.5.2000, me adrese: Tirane, Rruga e Durresit, pallati 34, shkalla 4, apartamenti 79, (i cili eshte i perbere nga tri dhoma, nje kuzhine, korridor, banje, si dhe ambiente te tjera ndihmese,ne katin e pare), (indeks 111-284-12011994).
5. Pasuria (nje shtepi 2-kateshe, konstrukcion tulle e mbuluar me tjegulla, si dhe nje siperfaqe trualli mbi te cilen ngrihet kjo shtepi), me siperfaqe 270 m<sup>2</sup>, me numer prone "Parcela 79" e planit urbanistik, me adrese: Tirane, fshati Selite e Vogel (Indeks 313-2544-04041996).
6. Pasuria (dyqan, ish-gjelltoire, ne Rrugen e Durresit), me siperfaqe 350 m<sup>2</sup>, numer pasurie 4225, date 21.06.2000, me adrese: Tirane, Rruga e Durresit, pallati 102, (Indeks 307-6150-30.12.1995).
7. Pasuria (dyqan, ish-permanent, ne Rrugen e Elbasanit) me siperfaqen 47 m<sup>2</sup>, si dhe nje truall 47 m<sup>2</sup>, mbi te cilin eshte ngritur dyqani permanent, numer pasurie 208, date 21.1.1994,me adrese: Tirane, Rruga e Elbasanit (permanent i ndermjet repartit te berbereve dhe rrobaqepesise), (indeks dyqani permanent 276-208-21011994, indeks trualli 47 m<sup>2</sup> 307-6152-30121995).
8. Pasuria (lokal, ish-embeltore ne Rrugen e Durresit) me siperfaqe 175 m<sup>2</sup>, si dhe nje truall me siperfaqe 175 m<sup>2</sup>, mbi te cilin eshte ngritur lokali ish-embeltore me nr.pasurie 944, date 30.5.2000, me adrese: Rruga e Durresit, Tirane, (Indeks lokal

 5

embeltore 310-944-09021996,Indeksi I truallit nen lokalin embeltore 319-5558-25071996).

9. Pasuria (ndertese-magazina qendrore) me sipërfaqe 4437 m2, si dhe nje truall me sipërfaqe 4437 m2, mbi te cilin eshte ngritur objekti ndertese "Magazina qendrore", numer pasurie 3537, date 21.10.1993, me adrese: Laprake, rruga "Pandi Dardha", Tirane, numer (magazina qendrore ose ish-oficina e NB "17 Nentori") (Indeks objekti-ndertese-magazina qendrore, 3537-21101993, Indeks Trualli 307-6153-30121995).

10. Pasuria (truall) me sipërfaqe 22000 m2, zona kadastrale 3866, numer pasurie 4376, date 20.9.1997, me adrese: Tirane, fshati Yzberisht, kufizohet me rrugen automobilistike (Indeks 339-4376-20091997).

**Nga ana e paditesit permes ekspertizes private eshte realizuar llogaritja e fitimit te munguar nga sekuestrimi i pasurive te paluajtshme i ardhur per shkak te zhveshjes se paditesit nga disponimi i ketyre pasurive, si dhe nga keq administrimi, duke llogaritur (permes ekspertizes private) shumat minimale te perfituara, sikur te mos kishte ndodhur fenomeni i sekuestrimit pasurive te paluajtshme dhe keto pasuri te ishin disponuar/zhvilluar ne menyre simetrike me te trete sipërmarres ne vend. Llogaritjet jane bere sikur pasurite e paluajtshme te ishin dhene me qira me cmimet e tregut duke zbritur shpenzimet, taksat dhe tatimet e shumat e kthyera nga AAPSK, si dhe per pasurine truall duke konsideruar mundesine e zhvillimit te kesaj prone sipas dy menyrave.**

**Llogaritjet e paditesit tregohen ne menyre analitike ne ekspertizen private ndersa shuma e parashtruar perben vetem objektin minimal i cili duhet te shtohet me demin e shkaktuar paditesit per shkak te keqadministrimit te Ministrise se Financave, AAPSK dhe fitimit minimal nga investimi i shumave te llogarive bankare te sekuestruara ne bono thesari.**

**Llogaritjet per pasurite e paluajtshme jepen ne tabelen vijuese (ndersa llogaritjet e plota analitike per secilen pasuri per te mos renduar kete dokument, do te jepen me aktin e ekspertimit te paditesit):**

NR	PERSHKRIMI I PASURISE	SIP. M2	Vlera ne leke Totale	TVSH	Vlera ne leke pa TVSH	Shpenzime	Te ardhura nga AAPKS	FITIMI MUNGUAR
1	DYQAN ISH-GJELTORE, RR.							


DURRESIT								
1.	DYQANI 13/2	90	10,959,808	611,279	10,348,529	87,255	10,144,382	116,892
2.	DYQANI 13/4	30	3,653,269	203,760	3,449,510	29,085	4,693,798	-
3.	DYQANI 13/3	30	3,653,269	203,760	3,449,510	29,085	4,091,552	-
4.	DYQANI 13/5	30	4,566,587	254,700	4,311,887	29,085	3,880,828	401,974
5.	DYQANI 13/1	35	3,653,269	203,760	3,449,510	33,933	4,883,208	-
6.	DYQANI 13/6	35	1,454,250	91,667	1,362,583	33,933	105,710	1,222,941
2	MAGAZINA LAPRAKE							
1.	MAGAZINE 1	360	8,961,596	472,928	8,488,668	351,600	6,837,428	1,299,640
2.	MAGAZINE 5	212	9,122,984	482,050	8,640,935	207,053	6,224,564	2,209,318
3.	MAGAZINE	520	25,224,394	779,083	24,445,311	797,333	-	23,647,978
4.	MAGAZINE	424	16,382,527	864,051	15,518,476	414,319	9,857,339	5,246,818
5.	MAGAZINE	340	11,147,874	587,964	10,559,910	332,237	4,628,064	5,599,609
6.	MAGAZINE	456	13,086,634	690,219	12,396,416	445,588	6,868,114	5,082,714
7.	MAGAZINE	212	10,134,813	313,024	9,821,789	325,057	-	9,496,722
8.	MAGAZINE	241	5,275,539	278,244	4,997,295	235,497	3,580,279	1,181,519
9.	MAGAZINE	82	2,516,802	132,742	2,384,060	80,333	-	2,303,727
3	Lokal ish-embeltore rr. DR 15/1	70	9,080,983	521,597	8,559,385	67,900	3,665,990	4,825,495
	Lokal ish-embeltore rr. DR 15/2	105	9,475,808	544,276	8,931,533	101,850	4,356,454	4,473,228
4	Ap.5, Rr. Vaso Pasha Pll.2,shk.2	114	4,654,451	272,138	4,382,313	109,061	1,175,230	3,098,022
5	Dyqan ish-permanent Rr.Elbasanit	47	3,878,709	226,781	3,651,927	44,807	2,651,698	955,423
6	Ap.86, Rr. Reshit Collaku, Pll.shallvare, sh.7	76	4,266,580	249,460	4,017,120	71,977	1,774,623	2,170,521
7	Ap.79, Rr.Duresit pll.34, shk.4	88	2,368,952	136,069	2,232,883	85,360	1,078,977	1,068,546
8	Shtepi 2 kateshe Selit e vogel Tirane	270	7,896,507	453,563	7,442,944	261,900	1,023,057	6,157,987
9	Ap.3,Rr. Bajram Curri, pll.8 shk.1	71	0	0	0	0	-	-
10	Truall. Yzberishe, Tirane	22,000	1,527,330,000	0	1,527,330,000	0	1,083,121	1,526,246,879
	TOTALI	25,938	1,698,745,605	8,573,112	1,690,172,493	4,174,256	82,604,416	1,606,805,952

**Demt i pesuar nga paditesi per shkak te sekuestrimit dhe keqadministrimit te ketyre pasurive te paluajtshme eshte shume i madh.**

**Paditesi do te saktesoje kete shume per periudhen parardhese, si dhe do te kerkoje vleresimin e demit te pesuar si rezultat i sekuestrimit te llogarive bankare permes nje eksperti vleresues te pasurive te paluajtshme.**

Paditesi kerkon te shperblehet per te gjitha demet pasurore qe ka pesuar, per shkak te sekuestrimit te te gjitha llogarive si dhe kerkon fitimin te munguar si pasoje e sekuestrimit dhe keqadministrimit te pasurive.

Paditesi nuk konteston faktin e sekuestrimit, pasi legjislacioni ne fuqi i kohes e lejonte nje gje te tille. Pavaresisht kesaj, palet e paditura, pergjegjese per administrimin e ketyre




pasurive duhet te kishin prodhuar fryte civile, ne masen e percaktuar me lart ne kete padi. Sa me siper edhe sepse, **pavaresisht motivimit te ligjshem, pasoja ndaj pasurise se paditesit ka ardhur, e si e tille meriton te demshperblehet, sic edhe ligji per pergjegjesine e organeve te administrates dhe Kodi Civil parashikon.**

Ligji nr. 9258, date 15.07.2004 "Per masat kunder financimit te terrorizimit" (ne perputhje me te cilin eshte rregulluar sekuestrimi dhe administrimi), sanksionon se pas vendosjes se mases se sekuestrimit palet e paditura ne cilesine e organeve pergjegjese shteterore kane qene te ngarkuara per te ushtruar te gjitha te drejtat e kontrollit mbi fondet dhe pasurite e sekuestruara, perfshire posedimin, administrimin, dhe veprime te tjera, si dhe implikon mbledhjen e frutave civile nga pasurite e sekuestruara.

Administrimi i fondeve dhe asetëve nuk ka qene ceshtje vullneti prej paleve te paditura, por ka qene "Detyrim Ligjor" ne cilesine e organeve shteterore kompetente per te administruar pasurite e bllokuara. Sa me siper eshte ne perputhje edhe me parashikimet e Kodit Civil: Neni 419 i KC: Detyrimi eshte nje marredhenie juridike me anen e se ciles nje person (debitori) detyrohet te jape dicka ose te kryeje apo te mos kryeje nje veprim te caktuar ne dobi te nje personi tjetër (kreditori)... Neni 420 i KC: Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji.

Veprimet e kunderligjshme te pales se paditur Ministria e Financave vertetohen se pari nga menyra e marrjes ne dorezim te seciles pasuri te paluajtshme ne pronesi te paditesit duke marre forcerisht ne dorezim cdo pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme te paditesit. Pala e paditur Ministria e Financave nuk ka nenshkruar as edhe nje akt te vetem per marrjen ne dorezim te sendeve se paku per te vertetuar gjendjen faktike te ketyre pasurive te paluajtshme si dhe per sendet e luajtshme brenda ketyre ambienteve.

Pavaresisht menyres se marrjes ne dorezim, pala e paditur Ministria e Financave, nuk ka bere as edhe nje veprim te vetem per te administruar pasurite e sekuestruara apo se paku t'ja transferonte per administrim organeve shteterore kompetente. Ne baze te nenit 3 pika 2 paragrafi 2 te Ligjit nr. 9258 date 15.07.2004, pas vendosjes se mases se sekuestrimit palet e paditura, ne cilesine e organeve pergjegjese shteterore kane qene te ngarkuara per te ushtruar te gjitha te drejtat e kontrollit mbi fondet dhe pasurite e sekuestruara, perfshire posedimin, administrimin, dhe veprime te tjera qe i cmojne te nevojshme.





Nisur nga sa me lart, rezulton e qarte se administrimi i fondeve dhe asetëve nuk ka qene ceshtje vullneti prej paleve te paditura, por ka qene "Detyrim Ligjor" ne cilesine e organeve shteterore kompetente per te administruar pasurite e blokuara.

Ne vijim te parashtrimit te mesiperem, ligji nr. 9258 date 15.07.2004 se bashku me dispozitat zbatuese perkatese, percaktonte nga njera ane masat e nevojshme per ngrirjen e fondeve dhe asetëve te personave te dyshuar si financues te terrORIZIMIT, nga ana tjetër njekohesisht percaktonte qarte te drejtat, detyrimet, dhe kompetencat e paleve te paditura si organet shteterore pergjegjese ne administrimin e pasurive te sekuestruara. Permendim/citojme ne kete drejtim nder te tjera:


3.2.par.II: Pas vendosjes se mases te sekuestrimit, organet pergjegjese ushtrojne te gjitha te drejtat e kontrollit mbi fondet dhe pasurite e tjera te sekuestruara, perfshire posedimin, administrimin dhe veprime te tjera, qe i cmojne te nevojshme.....

15.6.: Zbatimi i mases se bllokimit te perkohshem ose te sekuestrimit nuk pengon mbledhjen e interesave dhe marrjen e perfitimeve nga fondet dhe pasurite e tjera. Keto masa shtrihen automatikisht edhe mbi fonde dhe pasuri te tjera qe fitohen pas zbatimit te tyre.

20.2: Ne rastin e sekuestrimit te nje pasurie te paluajtshme, kopja e akteve perkatese dhe e vendimit te gjykates i dergohen zyres perkatese te regjistrimit te pasurive te paluajtshme. Kjo e fundit eshte e detyruar te marre masa per ekzekutimin e menjehershem te tyre.

20.3. Per administrimin e pasurive te blokuara e te sekuestruara, sipas ketij ligji, zbatohen dispozitat ne fuqi per strukturat pergjegjese dhe procedurat per fondet dhe pasurite e sekuestruara te konfiskuara ne procedime penale ose jashte tyre.

Nga momenti kur keto pasuri jane blokuar, ka qene detyrim i te paditurit Ministria e Financave ti kalonte ne dorezim pales se paditur AAPSK, cdo pasuri apo fond te sekuestruar, si organi shteteror kompetent per administrimin e pasurive te sekuestruara dhe te konfiskuara. Ne fakt te gjitha asetet e blokuara jane marre ne dorezim nga i padituri AAPSK me vonese, cfare perben nje veprim me faj te rende dhe ne shkelje te ligjit e konkretisht e nder te tjera te VKM nr. 503, date 30.06.2005, "Per Organizimin, Kompetencat dhe Funksonimin e Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara", i cili percakton detyrimin e pales se paditur AAPSK per te administruar fondet dhe pasurite e sekuestruara te personave te dyshuar apo te shpallur si pjesemarres ne krimin e organizuar. Me VKM 968 date 02.07.2008 "Per Organizimin, Kompetencat dhe Funksonimin e Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara" si akt shfuqizues




I VKM 503, date 30.06.2005, pervec sa parashikon ky i fundit parashikon shprehimisht edhe se Agjencia ka per objekt te veprimtarise: ....b) administrimin e pasurive te sekuestruara ne zbatim te ligjit nr. 9258 date 15.07.2004 "Per masat kunder financimit te terrorizmit" dhe se pasurite e sekuestruara dhe konfiskuara, te cilat jane objekt i veprimtarise se Agjencise, merren ne administrim përmes nje akti te marrjes ne dorezim, te mbajtur nga perfaqesues te autoritetit, qe ka vendosur sekuestron, perfaqesues te Agjencise dhe administratorit te pasurise.

*Edhe i padituri AAPSK per perludhen pasi ka marre ne dorezim pasurite e paluajtshme dhe vlerat monetare nuk ka vepruar ne perputhje me ligjin dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij. Gjate gjithë perludhes kohore qe cdo pasuri e paluajtshme e paditesit ka qene nen administrimin efektiv te pales se paditur AAPSK, keto pasuri jane demtuar dhe keqadministruar, shpeshhere duke u dhene per shfrytezim ne formen e huaperdorjes, si dhe duke u dhene keto pasuri per shfrytezim paleve te treta ne formen e qirase me ulet sesa vlera reale e tregut per cdo vit perkates!*

VKM nr. 503, date 30.06.2005, "Per Organizimin, Kompetencat dhe Funkcionimin e Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara" percakton detyrimin e pales se paditur AAPSK per te administruar fondet dhe pasurite e sekuestruara.

VKM 968 date 02.07.2008 "Per Organizimin, Kompetencat dhe Funkcionimin e Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara" si akt shfuqizues i VKM 503, date 30.06.2005 pervec sa parashikon ky i fundit parashikon shprehimisht se "Kreu II - Agjencia ka per objekt te veprimtarise: ....b) administrimin e pasurive te sekuestruara ne zbatim te ligjit nr. 9258 date 15.07.2004 "Per masat kunder financimit te terrorizmit" si dhe ne menyre eksplicite permendet investimi ne bono thesari e mbledhja e interesave bankare.

**Nje dem vecanerisht i madh i eshte shkaktuar paditesit per shkak te mosshfrytezimit te pasurise se paluajtshme Pasuria (trual) me sipërfaqe 22000 m2, zona kadastrale 3866, numer pasurie 4376, date 20.9.1997, me adrese: Tirane, fshati Yzberisht, e cila kufizohet me rrugen automobilistike (indeks 339-4376-20091997). Kjo pasuri eshte trajtuar si mall pa zot nderkohe qe (referuar edhe objektit te aktivitetit te shoqerise dhe motivimit perkates ne blerje) do te ishte perdorur e futur ne qarkullim civil duke prodhuar edhe perfitimet perkatese.**



Procedurat per te llogaritur demin e shkaktuar per kete pasuri konsistojne ne dy menyra:

Menyra e pare eshte kompensimi sikur shoqeria te jepte truallin per ndertim duke ndjekur percaktimet e referuar Rregullores per zberthimin dhe zbatimin e studimit urbanistik te zones ne perendim te qytetit te Tiranës (Komuna Kashar) kreu 10 "Menaxhimi i Tokës" dhe Menyra e dyte eshte qe shoqeria te vazhdonte te ndertonte ne pasurine Truall 22,000m2 e te vilte frute civile nga pasurite e perftuara.


#### **Menyra e pare.**

Nga sekuestrimi i pasurise truall eshte pesuar humbje financiare per arsye se ne zbatim te Ligji nr 8405 date 17.09.1998 "Per urbanistikën " dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij, dhe Vendimi Keshillit te Rregullimit te Territorit te RSH nr 1 date 01.06.2006 "Per miratimin e Studimit Urbanistik te zones ne perendim te qytetit te Tiranës, Komuna Kashar, me siperfaqe 235.5 ha" Shoqeria Lloxhall shpk do te kishte perfituar duke aplikuar per zhvillimin e prones, dhe konkretisht:

1. Ne planin e zhvillimit te zones ku ndodhet pasuria e sekuestruar e shoqerise Lloxhall shpk eshte percaktuar si zone per ndertime objekte banimi dhe sherbimi, ndersa Pasuria Truall 22,000 m2 eshte planifikuar per ndertimin e objekteve publike ne interes te komunitetit te zones.
2. Referuar Rregullores per zberthimin dhe zbatimin e studimit urbanistik te zones ne perendim te qytetit te Tiranës (Komuna Kashar) kreu 10 "Menaxhimi i Tokës" percakton qarte menaxhimin e siperfaqes se tokave duke i perfshire ne perfitimin e siperfaqes se ndertimit. Si baze do te jete marreveshja kontraktuale ndermjet pronarit te tokes dhe investitoreve ne perputhje me parashikimet e studimit urbanistik.

Sa me siper bazohet ne leje te dhena per kete zone ne te cilen ndodhet e dhe pasuria e sekuestruar, ku jane percaktuar koeficientet e shfrytezimit te truallit per ndertim si dhe perqindja qe perfitojne pronaret e truallit ne baze te kontratave qe kane lidhur me investitoret per dhenjen e truallit per ndertim.

Me vendim nr 18 date 18.10.2006 te KRRT Komuna Kashar, eshte miratuar Leje ndertimi per objekte banimi dhe sherbimi me koeficient shfrytezimi mesatarisht 45.60% te siperfaqes se Truallit. Siperfaqja e pergjitheshme e ndertimit perfitohet nga nr i kateve qe



ne evidencen e siguruar eshte 10 kate. Pronaret e truallit perfitojne ne baze te kontratave noteriale per dhenien e truallit per ndertim 29% te siperfaqes se pergjitheshme te ndertuar.

Konkretisht per pasurin e sekuestruar truall me siperfaqe 22,000 m2 sipas koeficenteve te siperctuar me 45.60% do te jete 10,032m2 siperfaqe e gjurmes se ndertimit e logaritur me nr e kateve qe eshte miratuar per zonen, ndertohet 100,320 m2 siperfaqe ndertimi.


Pronari i truallit te sekuestruar do te perfitonte 29,092 m2 ndertim. Ne baze te Udhezimit te Keshillit te Ministrave nr 4 date 30.09.2015 "Per miratimin e Kostove mesatare te ndertimit te banesave nga Enti Kombetar i Banesave per vitin 2015" vlerat mesatare te banesave ne tregun e lire ne Komunen Kashar eshte 52,500 lek/m2. Nga siperfaqja e perftuar dhe cmimi mesatar i shitjes llogaritet qe fitimi i munguar eshte ne Shumen 1,527,330,000 leke, ( 29,092 m2 \* 52,500 lek/m2).

### **Menyra e dyte**

Menyra e dyte konsiston ne fitimi e realizuar ne rast se paditesi do te vazhdonte te ndertonte ne pasurine Truall 22,000m2. Ne baze te ligjit nr 8405 date 17.09.1998 "Per urbanistiken " dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij, dhe Vendimi Keshillit te Rregullimit te Territorit te RSH nr 1 date 01.06.2006 "Per miratimin e Studimit Urbanistik te zones ne perendim te qytetit te Tiranës, Komuna Kashar me siperfaqe 235.5 ha" Shoqeria Llohall shpk do te kishte perftuar duke aplikuar per zhvillimin e prones.

Me vendim nr 18 date 18.10.2006 te KRRT Komuna Kashar ka miratuar Leje ndertimi per objekte banimi dhe sherbimi me koeficient shfrytezimi mesatarisht 45.60% te siperfaqes se Truallit, referuar rasteve te ngjashme qe kufizojne me truallin ne pronesi te shoqerise Llohall shpk. Siperfaqja e pergjitheshme e ndertimit perfitohet nga nr i kateve qe ne evidencen e siguruar eshte 10 kate. Nisur nga sa me siper shoqeria Llohall shpk nderton per pasurin e sekuestruar truall me siperfaqe 22,000 m2 sipas koeficenteve te siperctuar me 45.60% do te jete 10,032m2 siperfaqe e gjurmes se ndertimit e logaritur me nr e kateve qe eshte miratuar per zonen, ndertohet 100,320 m2 siperfaqe ndertimi.

Duke marre ne evidence ndertimet perrreth prones se sekuestruar te cilat kane filluar ndertimin ne vitin 2006 dhe kane perfunduar ne vitin 2009 perlllogaritje per venien ne shfrytezim te pasurise do te fillojme nga viti 2010. Vlera mesatare e qerases per m2 siperfaqe ndertimi ne kete zone eshte 1 euro/m2.



Fitimi i munguar i shoqerise nga sekuestrimi i pasurise Truall 22,000m2 per nje vit eshte 1,203,840 euro ( 100,320m2\*1euro/m2\*12muaje). Ndersa per gjithë periudhen duke filluar nga viti 2010 deri ne fund te vitit 2015 eshte 7,223,040 euro ( 1,203,840 euro/vit\*6 vite). E konvertuar me kursin e Bankes se Shqiperise ne fund te vitit 2015 qe eshte 1 euro barabarte me 137.28 lek kemi fitimin e munguar 991,578,931 leke.

**Ne vijim te arsytimit te mesiperm, del qarte se palet e paditura duhet te mbajne pergjegjesi jashtekontraktore solidare per te gjitha demet qe i kane shkaktuar paditesit per shkak te sekuestrimit dhe keqadministrimit te asetëve. Ndersa keqadministrimi gjen shprehje ne mosmbledhjen e frutave civile dhe kalimin e vone te shumave AAPSK, pergjegjesia pavaresisht apo ne total percaktohet edhe me ligjin nr. 8510 date 15.07.1999 "Per pergjegjesine jashtekontraktore te organeve te administrates shteterore" (i ndryshuar) i cili percakton se organet shteterore ne ushrimin e funksioneve respektive publike mbajne pergjegjesi jashtekontraktore duke shperblyer demet e shkaktuara se bashku me fitimin e munguar! Administrimi i mire i ketyre pasurive perben nje rregullim qe synon te minimizoje demin qe vete organet shteterore do te duhet te shperblejne ne hipotezen qe masa e sekuestros hiqet apo ble shkak ligjor qe ka prodhuar pasojen. Ligji 8510 parashikon nder te tjera:**

#### *Neni 1*

##### *Pergjegjesia jashtekontraktore e organeve te administrates shteterore*


*Organet e administrates shteterore pergjigjen per demet pasurore dhe jopasurore jashtekontraktore, qe u shkaktojne personave fizike a juridike, private, vendas a te huaj.*

*Pergjegjesia jashtekontraktore e organeve te administrates shteterore rregullohet me dispozitat e ketij ligji dhe te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.*

#### *Neni 2*

##### *Perkufizime*

*Per qellimet e ketij ligji termat e meposhtem kane kuptimet si vijon: "Pergjegjesi jashtekontraktore e organeve te administrates shteterore" kuptohet detyrimi i organeve te administrates shteterore per te shperblyer demin qe keto te fundit i kane shkaktuar interesave te personave private ne ushrim e siper te funksioneve te tyre publike....."*



**Neni 3**

**Rastet e pergjegjesise se organeve shteterore**

Organet e administrates shteterore pergjigjen per demet qe u shkaktojne personave fizike a juridike private ne rastet qe vijojne:

- a) kur kryejne veprime a mosveprime te kunderligjshme;
- b) kur kryejne veprime a mosveprime te ligjshme, por qe sjellin demtimin e interesave te ligjshme te personave fizike a juridike private;
- c) kur, megjithese kryejne veprime a mosveprime te ligjshme, u shkaktojne nje dem te pabarabarte subjekteve te cileve u drejtohet ky veprim a mosveprim;
- c) kur, per shkak te mosfunksionimit te mjeteve teknike me te cilat organet e administrates shteterore ushtrojne veprimtarine e tyre, persona fizike a juridike private cenohen ne interesat e tyre te ligjshme;
- d) kur u shkaktojne nje rrezik te vazhdueshem personave fizike a juridike private.

**Neni 6**

**Shperblimi**

Shperblimi qendron ne pagimin e nje sasie te hollash per te barazpeshuar nje dem, i cili nuk mund te ndreqet ne menyre te drejtperdrejte

**Neni 8**

**Raportet ndermjet llojeve te demshperblimeve**

Ne rastin e shkaktimit te demit pasuror, organi kompetent i administrates shteterore vendos te pranoje kerkesen e te demtuarit per kompensim ne te holla ne vend te zhdukjes se shkaqeve dhe te kthimit, vetem ne rast se kjo zhdukje e shkaqeve dhe kthimi nuk jane te mundur.


Ne rastin e shkaktimit te demit moral, shperblimi behet ne te holla.

Demi moral konkuron me demin pasuror dhe me demet e tjera jopasurore.

**Neni 10**

**Fitimi i munguar**

Ne shperblimin e demit perfshihet ne cdo rast, fitimi i munguar, si dhe demi jopasuror, ne perputhje me nenin 12.



Neni 14

Debitorët solidare

**Kur përgjegjës për shkaktimin e dëmit janë disa organe të administratës shtetërore, secili prej tyre mban përgjegjësi për të gjithë dëmin. Ata përgjigjen kundrejt të dëmtuarit si debitorë solidare.**

**Sa më sipër është në harmoni edhe me parashikimet e Kodit Civil, nenet 640 e vijues etj.**

Se fundmi referuar të gjithë dispozitave ligjore të kohës për bllokimin e asetëve të shtetasit Yassin Kadi, rezultoi se ky i fundit ishte person i dyshuar për financimin e terrorizmit ndërsa në asnjë rast nuk u vertetua fajësia e tij. Një fakt i tillë shpjegohet edhe me faktin e pakundershtueshëm se pavarësisht një periudhe kohore kaq të gjatë nën sekuestrim asetet nuk u konfiskuan asnjëherë dhe nuk kaluan asnjëherë në pronësi shtetërore.

**Për në konkluzion përditesit kërkon të shpërblehet për të gjithë dëmin pasuror jashtëkontraktor të pesuar sikur fenomeni i sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të mos kishte ndodhur dhe këto pasuri të ishin nën posedimin e disponimin e përditesit minimalisht në masën e paralogaritur në lenden e kesaj kerkese-padie, duke rezervuar të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve procedurale që mundësojnë saktësimin/shtimin e objektit përmes llogaritjeve që mund të bëjë një ekspert/grup ekspertësh të caktuar nga gjykata!**


**Në përfundim kërkojme:**

**Pranimin e padisë sipas objektit.**

-----

Tirane, më 01.02.2016

Per përditesin  
Av. Altin Ibro



15